



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	359
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	26.07.2023
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr: 01/359/2023

Datë: 25.07.2023

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.1) dhe nenit 11 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2023, merr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet Rregullorja Nr. 02/2023 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo

Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Në bazë të nenit 10 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe në pajtim me nenin 11 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e datës 25.07.2023, Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë miraton këtë:

RREGULLORE

(AD) NR.02/2023

**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.02/2017 PËR
PUNËN E KËSHILLIT DREJTUES TË AKADEMISË SË DREJTËSISË**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores nr.02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore janë të zbatueshme për anëtarët e Këshillit, zyrtarët që janë prezent gjatë mbledhjeve të Këshillit, organet e Akademisë, si dhe secilin subjekt tjetër me të cilin ndërlihet puna e Këshillit.

Neni 3

Neni 6 i Rregullores nr.02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, plotësohet dhe ndryshohet si në vijim:

Neni 6

Kompetencat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues ka këto kompetenca:

- 1.1. miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me Ligjin për Akademinë;
- 1.2. miratimin e projektbuxhetit të Akademisë;
- 1.3. miratimin e strategjisë zhvillimore, planit të punës së Akademisë dhe programit të trajnimeve;

- 1.4. drejtimin dhe mbikëqyrjen e performancës dhe veprimtarisë të Akademisë së Drejtësisë;
- 1.5. hartimin dhe miratimin e planit vjetor të performancës së Akademisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv dhe organet e tjera të Akademisë;
- 1.6. miratimin e listës së trajnerëve dhe mentorëve;
- 1.7. përcaktimin e prioriteteve në ofrimin e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- 1.8. zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv;
- 1.9. emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Programor;
- 1.10. themelimin e komisioneve të veçanta që do ta ndihmonin në ushtrimin e kompetencave të Këshillit;
- 1.11. kryerjen e punëve të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.

Neni 4

Neni 19 i Rregullores nr.02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, fshihet në tërësi.

Neni 5

Pas nenit 18 të Rregullores nr.02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, shtohen nenet në vijim:

Neni 19

Drejtimi dhe mbikëqyrja e Akademisë së Drejtësisë

1. Drejtimi dhe mbikëqyrja e Akademisë realizohet nëpërmjet:
 - 1.1. sistemit të menaxhimit të performancës, dhe
 - 1.2. instrumenteve specifike të drejtimit dhe mbikëqyrjes.
2. Këshilli Drejtues i Akademisë ushtron, drejtimin dhe mbikëqyrjen e performancës dhe veprimtarisë të Akademisë së Drejtësisë.

Neni 20

Sistemi i menaxhimit të performancës në Akademinë e Drejtësisë

1. Këshilli Drejtues i Akademisë në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv dhe organet e tjera të Akademisë harton dhe miraton planin vjetor të performancës së Akademisë së Drejtësisë.
2. Plani i performancës, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshin:
 - 2.1. kuadrin logjik, që përcakton objektivat, produktet dhe rezultatet specifike për t'u arritur, të kombinuar me treguesit e performancës, indikatorët dhe detyrat përkatëse, si dhe
 - 2.2. pjesën financiare, që specifikon buxhetin e Akademisë dhe shpërndarjen e tij sipas rezultateve specifike për t'u arritur.

3. Plani i performancës miratohet nga Këshilli Drejtues i Akademisë jo më vonë se 31 dhjetori i vitit paraardhës dhe i njëjti publikohet në web-faqen e Akademisë.

4. Drejtori Ekzekutiv i Akademisë paraqet para Këshillit Drejtues për miratim Raportin e Performancës më së voni deri me 31 mars të vitit pasardhës, dhe i njëjti pas miratimit publikohet në web-faqen e Akademisë. Raporti i performancës përfshin informacion të detajuar për arritjen e objektivave, produkteve dhe rezultateve të përcaktuara në planin e performancës.

Neni 21

Instrumentet specifike të mbikëqyrjes dhe drejtimit të Akademisë së Drejtësisë

1. Për ushtrimin e mbikëqyrjes së Akademisë, Këshilli Drejtues ka të drejtë:

1.1. të kërkojë informacion dhe dokumente lidhur me punën e Akademisë;

1.2. të ndërmarrë inspektime lidhur me ligjshmërinë, efektivitetin dhe eficiencën e punës të Akademisë dhe të nxjerrë urdhra të detyrueshëm për korrektimin e veprimeve bazuar në rezultatet e inspektimit;

1.3. të nxjerrë udhëzime të detyrueshme lidhur me zbatimin e objektivave të përcaktuar në planin vjetor të performancës.

2. Këshilli Drejtues i Akademisë nuk mund të japë urdhër apo udhëzime lidhur me procedurat administrative për çështje të caktuara konkrete dhe individuale në kompetencë të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë.

Neni 6

Nenet 20, 21 dhe 22 të Rregullores nr.02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, rinumërohen gjegjësisht neni 20 rinumërohet si neni 22, neni 21 rinumërohet si neni 23 dhe neni 22 rinumërohet si neni 24.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Prishtinë, 25/07/2023